



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-21167/20 datë:21.10.2020



Npi – 01/240 datë: 29.10.2020

Duke u bazuar në nenin 12.2 (pika c) nenin 17 (pika s) dhe nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neni 9 dhe 12 i Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Nr. 06/L-005; Neni 9 i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Neni 10.4 i Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për Transparencë në Komuna Nr.04/2018; Si dhe Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna Nr.06/2018; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR DISKUTIM PUBLIK TË
DRAFT - RREGULLORES KOMUNALE PËR TATIMIN NË PRONËN E
PALUAJTSHME PËR VITIN 2021

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më: 29.10.2020, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft - Rregulloren Komunale për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021, në afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra e Kryetarit – Sektori i Financave me Zyrën për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj